R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë
B A S H K I A P O L I Ç A N
DREJTORIA E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE

N J O F T I M

Në zbatim te ligjit **Nr. 86/2025 "*Për fshirjen, shuarjen dhe pagesën e detyrimeve tatimore ndaj administratës tatimore qendrore e vendore dhe e detyrimeve të pagueshme në doganë",*** njoftohen të gjithë tatimpaguesit e Bashkisë Poliçan që kanë detyrime pa paguara deri më 31.12.2024, se perfitojne lehtesitë e më poshtme :

1. Fshihen/shuhen detyrimet e papaguara, të përcaktuara sipas ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar, që u përkasin periudhave tatimore deri në datën 31 dhjetor 2014.

2.Për taksat /tarifat vendore të papaguara që u perkasin periudhave tatimore nga 1janar 2015 deri në 31 dhjetor 2019,detyrimi do të shuhen si më poshtë:

a) shuhet 50% e detyrimit tatimor nëse pjesa e mbetur 50% e tatimit/taksës/tarifës paguhet e gjitha njëherësh brenda datës 30.6.2026;
b) shuhet 25% e detyrimit tatimor nëse pjesa e mbetur 75% e tatimit/taksës/tarifës paguhet brenda datës 31.12.2026.

Në të dyja rastet, sipas shkronjave "a" e "b" të kësaj pike, gjobat dhe kamatëvonesat për periudhat përkatëse fshihen plotësisht.

3. Shuhen gjobat dhe kamatëvonesat për detyrimet që u përkasin periudhave tatimore nga data **1 janar 2020 deri në datën 31 dhjetor 2024, me kusht që tatimi/taksa/tarifa për periudhën përkatëse të paguhet brenda datës 31.12.2026.**

4. Ky ligj, i shtrin efektet nga data 1janar 2026 deri në 31dhjetor 2026.

Ju ftojme të shlyeni detyrimet brenda afateve ligjore për të përfituar nga këto lehtësira.

Qytetarët e intetresuar të paraqiten pranë Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore,Bashkia Poliçan ose pranë zyrave të taksave në Njesitë Administrative Vërtop dhe Tërpan.